



Datë: 30.05.2025
Numër Protokolli: 3690/2025

A.nr.681/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.681/2025 të datës 18.04.2025, të parashtruar nga ankuesit Y.S, M.H, B.K, E.A, K.E, J.E, E.Sh, V.B, J.B, D.R dhe A.L, të cilët me autorizim i përbashkët Yll Spanca, nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Ministra Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 30.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.681/2025, të datës 18.04.2025, të parashtruar nga ankuesit Y.S, M.H, B.K, E.A, K.E, J.E, E.Sh, V.B, J.B, D.R dhe A.L.

II. Pala ankuese udhëzohet në procedurë të ndërmjetësimit.

A r s y e t i m

Ankuesit si në preambulë të këtij vendimi (tutje referuar vetëm ankuesit), më datë 17.04.2025, përmes emailit kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 18.04.2025, nën shenjen A.nr.681/2025, kundër mos kompensimit të orëve shtesë të punës të realizuara gjatë organizmit të dy kuvendeve themeluese të Odës së Inxhinierëve dhe Odës së Arkitektëve, për muajin dhjetor 2024 dhe janar 2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 29.04.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (tutje referuar MMPHI), ndërsa, kjo e fundit me datë 16.05.2025, ka kthyer përgjigje në ankesë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovë **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesit, **sepse**:

Nga administrimi i shkresave të kësaj çështje rrjedhë fakti se më Vendimin Nr.52/2024 të datës 02.08.2024, të Ministrit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, janë caktuar kushtet dhe kriteret për zbatimin e pjesshëm të masës 1.4-Skema e punësimit të garantuar për të rinjtë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, ashtu që, bazuar në këtë vendim, ankuesi Y.S sipas Kontratës për punë praktike, me numër protokolli 6226/24, të datës 30.09.2024, është punësuar si praktikant në MMPHI, për periudhën prej 10.10.2024 deri më 31.03.2025, dhe Kontratës për punë praktike me numër protokolli

2080/25 të datës 04.04.2025 është punësuar praktikant në MMPHI prej datës 01.04.2025 deri më datë 30.09.2025, ankuesja M.H, sipas Kontratës për punë praktike, me numër protokolli 6246/24, të datës 30.09.2024, është punësuar si praktikante në MMPHI, prej datës 01.10.2024 deri më datë 31.03.2025, dhe Kontratës për punë praktike me numër protokolli 2072/25, të datës 04.04.2025, është punësuar praktikante në MMPHI prej datës 01.04.2025 deri më datë 30.09.2025; ankuesja B.K, sipas Kontratës për punë praktike, me numër protokolli 7246/24, të datës 01.11.2024, është punësuar si praktikante në MMPHI, prej datës 01.11.2024 deri më datë 30.04.2025 dhe Kontratës për punë praktike, me numër protokolli 3848/25, të datës 13.05.2025, është punësuar praktikante në MMPHI prej datës 02.05.2025 deri më datë 31.10.2025; ankuesi E.A, sipas dhe Kontratës për punë praktike, me numër protokolli 7244/24, të datës 01.11.2024, është punësuar praktikant në MMPHI prej datës 01.11.2024 deri më datë 30.04.2025 dhe Kontratës për punë praktike, me numër protokolli 3845/25, të datës 13.05.2025, është punësuar praktikant në MMPHI, prej datës 02.05.2025 deri më datë 30.10.2025; ankuesja K.E sipas Kontratës për punë praktike me numër protokolli 6237/2024 të datës 30.09.2024, është punësuar praktikante në MMPHI, prej datës 01.10.2024 deri më datë 31.03.2025 dhe Kontratës për punë praktike me numër protokolli 2074/25 të datës 04.04.2025, është punësuar praktikante në MMPHI. prej datës 01.04.2025 deri më datë 30.09.2025, ankuesja J.H sipas Kontratës për punë praktike me numër protokolli 6241/24 të datës 30.09.2024 është punësuar praktikante në MMPHI, prej datës 01.10.2024 deri më datë 31.03.2025, dhe Kontratës për punë praktike me numër protokolli 2069/25 të datës 04.04.2025, është punësuar praktikante në MMPHI, prej datës 01.04.2025 deri më datë 30.09.2025, ankuesja E.Sh, sipas Kontratës për punë praktike me numër protokolli 6247/24 të datës 30.09.2024 është punësuar praktikante në MMPHI, prej datës 01.10.2025 deri më datë 31.03.2025, dhe Kontratës për punë praktike me numër protokolli 2089/25 të datës 04.04.2025, është punësuar praktikante në MMPHI prej datës 01.04.2025 deri më datë 30.09.2025; ankuesja V.B sipas Kontratës për punë praktike me numër protokolli 6227/24 të datës 30.09.2024, është punësuar praktikante në MMPHI, prej datës 01.10.2024 deri më datë 31.03.2025 dhe Kontratës për punë praktike me numër protokolli 2081/25 të datës 04.04.2025, është punësuar praktikante në MMPHI prej datës 01.04.2025 deri më datë 30.09.2025, ankuesja J.B sipas Kontratës për punë praktike me numër protokolli 6245/24 të datës 30.09.2024, është punësuar praktikante në MMPHI, prej datës 01.10.2024 deri më datë 31.03.2025, dhe Kontratës për punë praktike me numër protokolli 2073/25 të datës 04.04.2025, është punësuar praktikante në MMPHI prej datës 01.04.2025 deri më datë 30.09.2025; ankuesja D.R, sipas Kontratës për punë praktike me numër protokolli 6225/24 të datës 30.09.2024, është punësuar praktikante në MMPHI, prej datës 01.10.2025 deri më datë 31.03.2025; ankuesja A.L sipas Kontratës për punë praktike me numër protokolli 6239/24 të datës 30.09.2024, është punësuar praktikante në MMPHI prej datës 01.10.2024 deri më datë 31.03.2025 dhe Kontratës për punë praktike me numër protokolli 2070/25 të datës 04.04.2025 është punësuar praktikante në MMPHI prej datës 01.04.2025 deri më datë 30.09.2025.

Tutje sipas shkresave të lëndës del se Kryesuesi i Komisionit Ministror për Themelimin e Odës së Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit më datë 10.12.2024 dhe 14.01.2025, ka parashtruar kërkesë tek zv. Sekretari i Përgjithshëm i MMPHI, për kompensim jashtë orarit të punës dhe gjatë fundjavës për Komisionin Ministror për Themelimin e Odës së Arkitektëve dhe Odës Inxhinierëve dhe stafit mbështetës, ndërsa, ky i fundit më datë 03.02.2025, ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli 567/25, me të cilin ka lejuar pagesat e orëve shtesë për punën jashtë orarit të rregullt për disa nëpunës të MMPHI-së duke përfshirë edhe ankuesit në cilësinë e praktikantëve.

Ankuesit më datë 12.03.2025 i janë drejtuar me kërkesë Komisionit Ministror për Themelimin e Odës së Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit, që të kompensohet për orët shtesë të punës për praktikantët për punën me datë 20 dhe 21 dhjetor 2024 dhe 24 dhe 25 janar 2025. Meqenëse nuk kanë marr përgjigje përfaqësuesi i përbashkët i ankuesve më datë 14.04.2025 përmes emailit i është drejtuar zyrtareve. I.B, A.B dhe Xh.M, ku ka kërkuar që afati për përgjigje ka kaluar dhe nuk kanë marrë përgjigje, ndërsa, Zyrtari Kryesor Financiar në MMPHI, më datë 15.04.2025, ka njoftuar përfaqësuesin e përbashkët të ankuesve: *Ne kemi shqyrtuar mundësinë e pagesave dhe me z. Kokollari-Menaxher i*

Kontratës dhe MFTP, nuk ka një bazë ligjore për t'ju mundësuar kompensimin e punës jashtë orarit ose vikendeve. Ju keni kontratë për punë praktike që subvencionoheni nga MFPT.

Ankuesit në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë se nuk janë kompensuar për orët shtesë të punës të realizuara gjatë organizmit të dy kuvendeve themeluese të Odës së Inxhinierëve dhe Odës së Arkitektëve, për muajin dhjetor 2024 dhe janar 2025, duke pretenduar tutje se një gjë e tillë ju takon sipas nenit 36 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenin 16 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës. Kërkojnë që të bëhet kompensimi për punë jashtë orarit për praktikantët.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të kompetencës lëndore për vendosje lidhur me këtë çështje ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 36 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet: *1. Çdo institucion publik mund të angazhojë praktikantë/e dhe gjatë punës praktike, praktikantë/it i sigurohet trajnimi praktik dhe teorik i nevojshëm, si dhe i mundësohet kryerja e punëve të caktuara. 2. E/i angazhuara/i në cilësinë e praktikantë/it, i cili ka lidhur kontratë për punë praktike me institucionin publik, i realizon të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës sikurse të punësuarit/it e tjerë .*

Ndërsa, Ligji Nr. 03/L-212 i Punës, më nenin 16 paragrafi 1 dhe 2 ka përcaktuar *1. Punëdhënësi mund të lidhë Kontratë Pune me praktikantin. 2. I punësuar i në cilësinë e praktikantit i cili ka lidhur kontratë pune me punëdhënësin, i realizon të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës sikurse të punësuarit e tjerë.*

Bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, Këshilli është kompetent të shqyrtoj dhe merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, andaj, duke qenë se ankuesit nuk kanë themeluar marrëdhënie pune në shërbim civil sikurse është e rregulluar me nenin 39 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, atëherë, rrjedhë së Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesve.

Në kuptim të së drejtës kushtetuese dhe ligjore për mbrojtje juridike të të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji duku u bazuar në nenin 9 të kontratave për punë praktike të lidhura në mes të ankuesve dhe punëdhënësit/MMPHI, ku është përcaktuar së në rast të mosmarrëveshjeve në mes palëve kontraktuese, të njëjtat fillimisht mosmarrëveshjet duhet ti zgjedhin në procedurë të ndërmjetësimit e në rast se një marrëveshje e tillë e ndërmjetësimit nuk është e arritshme, atëherë, palët kontraktuese mund të iniciojnë kontest civil në gjykatën themelore, në territorin e së cilës kryhet praktika, Kolegji në mbështetje të nenit 75 paragrafi 1 të LPPA-së udhëzoi palën ankuese në procedurë të ndërmjetësimit.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.681/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve Y.S;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MMPHI dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.